



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 3433₁₃ prot.

Tiranë, më 23.12.2024

VENDIM

Nr. 128, datë 23.12.2024

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT E POSAÇME QË OFRUESIT
E PLATFORMAVE TË SHPËRNDARJES SË VIDEOVE DUHET TË
PËRMBUSHIN PËR KRIJIMIN E OPERIMIN E SISTEMEVE TRANSPARENTE,
EFEKTIVE E MIQËSORE NË PËRDORIM”

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “e” si dhe nenin 32, pika 4/1, të ligjit nr. 97/2013, datë 19.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kërkesat e posaçme që ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove duhet të përmbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Armela

KRASNIQI

Zëvendëskryetar:

Desada

METAJ

Anëtarë:

Aurela

BICJA

Besian

ZOGAJ

Gjergji

HAMITI

Jetmir

HALILAJ

(Kundër)

Joana

ALLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

e | 1

RREGULLORE

PËR KËRKESAT E POSACME QË OFRUESIT E PLATFORMAVE TË SHPËRNDARJES SË VIDEOVE DUHET TË PËRMBUSHIN PËR KRIJIMIN E OFRIMIT E SISTEMEVE TRANSPARENTE, EFEKTIVE E MIQËSORE NË PËRDORIM”

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

1. Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 97/2013, datë 19.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Neni 32.4/1 e Ligjit)
2. Kjo rregullore është përafuar pjesërisht me Direktivën 2010/13/EU “Audiovisual Media Services Directive” (AVMSD), të amenduar me Direktivën 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.”

Neni 2 Objekti

1. Kjo rregullore synon të rregullojë parimet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme që duhet të përmbushin ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove për krijimin dhe operimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim.
2. Kjo rregullore synon gjithashtu të rregullojë kushtet e përgjithshme të ofrimit të përmbajtjeve audiovizive nga përdoruesit në platformat për shpërndarjen e videove dhe nuk prek shërbimet mbështetëse të transmetimeve audiovizive, me qëllim kryesor ofrimin e programeve për informim, argëtim ose edukim.

Neni 3

Fusha e Zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për përmbajtjet e ofruara nga platformat e shpërndarjes së videove nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë si dhe për përmbajtjet që i

drejtohen publikut shqiptar të ofruara nga platformat e shpërndarjes së videove të themeluara në një shtet tjetër.

2. Shërbimet mbështetëse të transmetimeve audiovizive, që i nënshtrohen përgjegjësisë editoriale, konsiderohen si shërbime mediatike audiovizive, edhe nëse ato ofrohen në një platformë për shpërndarjen e videove, të karakterizuar nga mungesa e përgjegjësisë editoriale. Në këtë rast, detyrimet ligjore mbarten nga ofruesit me përgjegjësi editoriale.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Përkufizimet e e kesaj rregullore kane kuptimesi sipas Direktives Audiovisual Media Services Directive” (AVMSD)

Neni 5 Ofruesit e shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë

1. Ofruesi i shërbimit të platformave të shpërndarjes së videove është në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë kur zyra apo struktura drejtuese e tij është në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes video, i cili nuk është themeluar në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të pikës 1, konsiderohet të jetë nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nëse:
 - a) shoqëria mëmë ose një degë e saj është themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - b) ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes video është pjesë e një grupi dhe një shoqëri tjetër e atij grupi është themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Ofruesi i shërbimit të platformave të shpërndarjes së videove informon AMA-n për çdo ndryshim që ndikon në përcaktimin e juridiksionit sipas parashikimeve të kësaj dispozite.

Neni 6 Rregulla për regjistrimin pranë AMA-s të platformave të shpërndarjes së videove në RSH

1. Ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove” është personi fizik ose juridik, i cili ofron shërbimin e platformës së shpërndarjes së videove.

1.1 AMA krijon dhe përditëson listën e ofruesve të platformave të shpërndarjes së videove nën juridiksionin e Republikën e Shqipërisë.

2. Ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove, brenda 30 ditëve nga kërkesa e AMA-s, duhet të njoftojnë pranë Autoritetit të dhënat e mëposhtme:

Faqe | 3

- a) emrin e shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove,
- b) të dhëna për ofruesin e shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove:

- i. në rastin e personit fizik, emrin, mbiemrin dhe adresën e regjistruar në RSH;
- ii. në rastin e një personi fizik të huaj, emrin, mbiemrin, shtetësinë, adresën e regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe adresën e selisë apo degës së regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
- iii. në rastin e një personi juridik, emrin e subjektit tregtar, adresën e selisë së regjistruar, emrat e aksionerëve apo ortakëve, formën e organizimit dhe adresën e regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë,
- c) adresën e selisë së ofruesit të shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove, nëse nuk është e njëjtë me adresën e selisë.
- ç) detajet e kontaktit, veçanërisht adresën elektronike.

3. Nëse njoftimi për të dhënat sipas pikës 2 të këtij neni nuk është i plotë, AMA e fton personin fizik ose juridik, që t'i plotësojë ato brenda një afati prej 30 ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës.

4. AMA i regjistron të dhënat e deklaruara sipas pikës 2 në listën e ofruesve të shërbimeve të platformës së shpërndarjes së videove brenda një afati prej 15 ditësh nga data e njoftimit të tyre dhe në të njëjtën kohë i dërgon subjektit që e ka bërë këtë njoftim, konfirmimin e regjistrimit në listë të ofruesve të shërbimeve të platformës së shpërndarjes së videove, duke treguar datën në të cilën është bërë regjistrimi.

5. Lista e plotë e ofruesve të platformave të shpërndarjes së videove të regjistruar në AMA është publike.

6. AMA, në përputhje me paragrafin 2, i publikon të dhënat në faqen zyrtare të internetit.

Neni 7

Rregulla të përgjithshme

1. Ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove nuk transmetojnë programe me përmbajtje që:

- a) nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtarit të një grupi mbi baza të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja, besimi, opinionimi politik, kombësia, anëtarësimi i një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia, moshë apo orientimi seksual, si dhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;

b) nxisin kryerjen e veprave terroriste.

2. Pa cenuar parashikimet e neneve 15 deri 20 të ligjit “Për tregtinë elektronike”, ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove marrin masat e nevojshme për:

a) mbrojtjen e fëmijëve nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit dhe komunikimet tregtare, që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre mendor, fizik ose moral;

b) mbrojtjen e publikut të gjerë nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit ;

c) mbrojtjen e publikut të gjerë nga programet, videot e gjeneruara nga përdoruesit dhe komunikimet tregtare audiovizive me përmbajtje, shpërndarja e të cilave përbën një aktivitet që është vepër penale sipas legjislacionit në fuqi apo provokim për të kryer një vepër terroriste, përbën vepër penale në lidhje me pornografinë për fëmijë, racizmin apo ksenofobinë.

Neni 8 Vetërregullimi dhe bashkërregullimi

1. AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator, nxit ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove për përgatitjen e kodeve të sjelljes, që përcaktojnë standardet dhe praktikatat që respektohen nga këto platforma.

2. Kodet e sjelljes duhet:

- a. të jenë të konceptuara në mënyrë që të pranohen gjerësisht nga palët e interesit;
- b. të përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë objektivat e tyre;
- c. të garantojnë respektimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të individit apo grupit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d. të parashikojnë një monitorim dhe vlerësim të rregullt, transparent e të pavarur të arritjes së objektivave të synuar;
- e. të sigurojnë një zbatim efektiv, përfshirë sanksione të efektshme dhe proporcionale.

3. Platformat e shpërndarjes së videove përgatisin dhe zbatojnë kode sjelljeje si marrëveshje të lira për të zbatuar kërkesa etike dhe profesionale në ushtrimin e detyrës, në favor të rritjes së cilësisë dhe shumëllojshmërisë së programeve audiovizive. Kodet e sjelljes publikohen edhe në faqet elektronike të ofruesve të platformave të shpërndarjes së videove.

KREU II RREGULLIMI I PLATFORMAVE TË SHPËRNDARJES SË VIDEOVE

Neni 9 Rregulla të përgjithshme të platformave të shpërndarjes së videove

1. Rregullat e përgjithshme për Platforma e Shpërndarjes së Videove janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 7 të kësaj Rregullore.

2. Në rastin kur platforma nuk është nën juridiksionin e RSH-së, por përmbajtja audiovizive në shkelje të pikës 1 të këtij neni shpërndahet nga përdoruesi në territorin e RSH-së ose është në gjuhën shqipe, AMA mund të kryejë sinjalizim (*flagging*) e kësaj përmbajtjeje të mbajtësi i platformës.
3. Në rast se mbajtësi i platformës sipas pikës 2më sipër nuk e fshin përmbajtjen audiovizive në shkelje nga sistemi i platformës ,AMA e sinjalizon përmbajtjen tek autoriteti rregullator i shtetit që ka juridiksionin për këtë platformë, për kompetencë të mëtejshme.

Neni 10

Përgjegjësia e Platformave

Platforma për shpërndarjen e videove ka përgjegjësi për të siguruar që përmbajtjet e ngarkuara nuk shkelin ligjet e brendshme të shtetit ku shfaqen këto përmbajtje si dhe për të siguruar masa mbrojtëse të mjaftueshme:

1. Platformat janë të detyruara të monitorojnë përmbajtjet e ngarkuara përmes algoritmeve automatike, të cilët identifikojnë përmbajtjet që përmbajnë shkelje të normave ligjore, dhe të veprojnë për heqjen e përmbajtjeve në rastet e shkeljeve të konstatuara.
2. Nëse një përmbajtje e paligjshme zbulohet nga përdoruesit ose palët e treta, platforma është e detyruar të ndërmarrë veprime të menjëhershme për heqjen e përmbajtjes dhe raportimin e saj.
3. Në rastet e komunikimeve tregtare të cilat çenojnë dispozitat e ligjit që lidhen me të drejtat e transmetimit të shërbimeve audiovizive, platforma duhet të veprojë për bllokimin e videove të komunimeve tregtare të sipërcituara.
4. Përdormi i platformave për të promovuar, nxitur ose tregtuar shërbime, të cilat janë të ndaluara me ligj, kërkon marrjen e masave emergjente për bllokimin e këtyre komunikimeve.

Neni 11

Komunikimet tregtare audiovizive në platformat e shpërndarjes së videove

1. Komunikimet tregtare për produkte, që platforma e shpërndarjes së videove ofron vetë, shet ose negocion:
 - a) duhet të jenë lehtësisht të dallueshme dhe pa mesazhe të fshehura tregtare,
 - b) nuk mund të përdorin teknika ndikimi të subkoshiencës,
 - c) nuk duhet të çenojnë dinjitetin njerëzor,
 - d) nuk mund të përmbajnë ose promovojnë diskriminim në bazë të gjinisë, racës ose origjinës etnike, shtetit, kombësisë, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual dhe
 - e) nuk mund të promovojnë sjellje që kërcënojnë shëndetin ose sigurinë apo sjellje jashtëzakonisht kërcënuese për mbrojtjen e mjedisit.

2. Platforma e shpërndarjes së videove nuk duhet të vendosë asnjë reklamë apo komunikim tregtar, që ai vetë ofron, shet ose negocion, nëse objekt i tyre janë cigaret dhe produktet e duhanit, produktet apo cigaret elektronike dhe produktet zëvendësuese për to.
3. Komunikimet tregtare, që platforma e shpërndarjes së videove ofron vetë, shet ose negocion, me objekt pijet alkoolike, nuk u drejtohen specifikisht të miturve dhe nuk nxisin konsumin e papërcaktuar të këtyre pijeve.
4. Komunikimet tregtare që platforma e shpërndarjes së videove i ofron vetë, shet ose negocion, nuk mund të kërcënojnë fizikisht, psikologjikisht ose moralisht të miturit nga:
 - a) nxitja drejtpërdrejtë për të blerë ose marrë me qera një produkt ose shërbim;
 - b) inkurajimi i drejtpërdrejtë për të bindur prindërit ose palët e treta që të blejnë mallra të reklamuar ose shërbime,
 - c) shpërdorimi i besimit të veçantë ndaj prindërve, mësuesve ose personave të tjerë, ose
 - d) përshkrimi i pajustificuar në situata të rrezikshme.
5. Detyrimet e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe në rastet e komunikimeve me natyrë tregtare në videot e krijuara nga përdoruesi në platformat e shpërndarjes së videove.

Neni 12

Masat mbrojtëse

1. Platforma e shpërndarjes së videove miraton masa mbrojtëse në përputhje me nenet e sipërcituara, në lidhje me natyrën e përmbajtjes përkatëse dhe dëmin që ajo mund të shkaktojë, karakteristikat e kategorive të personave, që mbrohen, të drejtat dhe interesat legjitime përkatëse, duke përfshirë interesat e veta dhe interesat e përdoruesve të platformës që krijojnë ose ngarkojnë përmbajtje dhe interesin publik.
2. Autoriteti Rregullator, i cili sinjalizohet nga AMA për përmbajtjet e ofruara nga platformat e shpërndarjes së videove, që e ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe për përmbajtjet, që i drejtohen publikut shqiptar nga platformat e shpërndarjes së videove të themeluara në një shtet tjetër, është i detyruar të marrë masa të menjëhershme, për t'u kërkuar ofruesve të platformave të shpërndarjes së videove nen juridiskion, heqjen e përmbajtjes së dëmshme sipas përcaktimeve të cituara në këtë rregullore
3. Masat mbrojtëse duhet të jenë të realizueshme dhe në proporcion me qëllimin dhe natyrën e shërbimit të ofruar nga platforma e shpërndarjes së videove dhe nuk duhet të çojnë në filtrim të përmbajtjes së ngarkuar apo në masa paraprake kontrolli.
4. Masat mbrojtëse janë të përshtatshme kur përfshijnë:
 - a) kërkesat e përcaktuara në nenin 7, në kushtet e shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove dhe zbatimin e tyre,
 - b) kërkesat e përcaktuara në nenin 5 në kushtet e ofrimit të shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove,

- c) mundësi informimi në rastet kur videot e ngarkuara në platformë përmbajnë komunikime tregtare.
- d) mekanizma transparentë dhe miqësorë, për t'u mundësuar përdoruesve komunikim me ofruesin e platformës së shpërndarjes së videove lidhur me përmbajtjet e ofruara në platformë,
- e) sisteme funksionale, me të cilat ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove informon përdoruesit e platformës për përpunimin e njoftimit të tyre ose etiketimin e përmbajtjes jo më vonë se 60 ditë nga data e njoftimit ose etiketimit të përmbajtjes,
- f) sistem funksional i verifikimit të moshës së përdoruesve të platformës për përmbajtje që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të të miturve;
- g) sistem funksionale dhe të lehtë në përdorim, që u mundëson përdoruesve fundorë vlerësimin e përmbajtjeve në përputhje me nenin 5.
- h) sistem të kontrollit prindëror për përdoruesit fundorë lidhur me përmbajtjet që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të të miturve,
- i) sistem transparent, të lehtë për t'u përdorur dhe procedura efektive për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve të platformës, që drejtohen te ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove lidhur me zbatimin e masave mbrojtëse, përfshirë informimin përdoruesve të platformës për mundësinë e zgjidhjes së çështjes së kontestuar jashtë gjykatë, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, masa dhe mjete efektive edukimi mediatic dhe ndërgjegjësimin e përdoruesve të platformës.

5. Mosmarrëveshjet e ndërsjella midis përdoruesit të platformës dhe ofruesit të shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove në juridiksionin e RSH lidhur me masat mbrojtëse, zgjidhen duke iu drejtuar gjykatës kompetente me padi.

Neni 13

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Mbrojtja e të dhënave personale në cdo rast do të behet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Autoriteti ruan anonimitetin/fshehtësinë e të dhënave në raportimet ndaj të tretëve.
3. Të dhënat personale të fëmijëve dhe jo vetëm, të mbledhura ose të marra nga ofruesi i platformës për shpërndarjen e videove nuk mund të përpunohen për qëllime komerciale, veçanërisht për marketing të drejtpërdrejtë, profilizimin dhe reklamat që ndikojnë sjelljen e konsumatorit.

KREU III

PROCEDURA PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE NGA AMA

Neni 14

Verifikimi dhe njoftimi i Autoritetit

1. Autoriteti në bazë të sinjalizimeve bën verifikimet e nevojshme për të konfirmuar praninë e përmbajtjeve që nuk përputhen me parimet e përcaktuara në nenin 5 dhe 11,

- në videot apo komunikimet me natyrë tregtare të ofruara nga platformat e shpërndarjes së videove.
2. Çdokush mund të njoftojë Autoritetin mbi shpërndarjen e videove të krijuara nga përdoruesit dhe komunikimeve tregtare audiovizive të dërguara në një platformë për shpërndarjen e videove, nëse konstaton përmbajtje në kundërshtim me parimet e përcaktuara në ligjin 97/2013 i ndryshuar dhe në këtë rregullore.
 3. Autoriteti njoftohet duke përdorur mundësitë e ofruara në faqen zyrtare ëeb të Autoritetit, duke bërë të ditur:
 - a) të dhënat personale të njoftuesit: emrin, mbiemrin dhe adresën ose vendbanimin ose emrin, përfaqësuesin ligjor dhe selinë në rastin e personave juridikë;
 - b) emrin e përdoruesit të platformës për shpërndarjen e videove, i cili është përgjegjës për shpërndarjen e videos së raportuar.
 - c) përmbajtjen, që mendohet se është e paligjshme, duke ofruar çdo element të dobishëm për vlerësimin e saj;
 - d) shkeljen apo/dhe interesin, që pretendohet të jetë shkelur përmes shpërndarjes së përmbajtjes së raportuar;
 - e) çdo element tjetër, të gjykuar si të dobishëm për vlerësimin e përmbajtjes së raportuar, kopje të njoftimeve të njoftimeve të mëparshme dhe rezultatin e tyre, kopje të korrespondencës eventuale ndërmjet tyre, etj.
4. Pavarësisht faktit se sinjalizimi mund të mos përmbajë elementët e parashikuar në paragrafin e tretë si më sipër, Autoriteti mund ta nisë procedurën e verifikimit nëse informacioni i vënë në dispozicion pavarësisht se jo i plotë, është i mjaftueshëm për këtë.
5. Verifikimi nga ana e Autoritetit nuk mund të nisë nëse për të njëjtën çështje ka nisur një procedim gjyqësor dhe tashmë përmbajtja e dëmshme është jashtë juridiksionit të rregullatorit.
 6. Procesimi i çdo sinjalizimi bëhet në bazë dhe për zbatim të Ligjit 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë si dhe përcaktimeve nënligjore të vendosura në këtë Rregullore.
 7. Raportimi i sinjalizimit pranë platformave të shpërndarjes së videove, në kuadër të bashkërregullimit bëhet në përputhje me Udhëzuesit e Funkcionimit të tyre.

Neni 15 Strukturat

1. Strukturat përgjegjëse për administrimin e raportimeve janë:
 - a. Këshilli i Ankesave
 - b. Drejtoria e Legjislacionit Ndërkombëtar dhe Integritimit
 - c. TIK
 - d. Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikqyrjes

Neni 16

Mospranimi i raportimit

1. Autoriteti refuzon raportimin ose pushon verifikimin, kur ankesa vlerësohet, se:
 - a) është abuzive, e pabazuar apo keqdashëse;
 - b) është opinion dhe nuk denoncon shkelje të të drejtave themelore të njeriut, sipas neneve 5-8 të kësaj rregulloreje;
 - c) ka për objekt video me fakte dhe informacione të paverifikueshme nga Autoriteti;
 - ç) kërkon parandalim të veprimeve të prishme apo që s'kanë ndodhur ende;
 - d) dhunon të drejtat kushtetuese të një pale të tretë;
 - gj) u referohet veprimtarive parlamentare, seancave gjyqësore apo veprimtarisë së subjekteve politike;
 - h) nuk është në interes të publikut.

Neni 17

Arkivimi administrativ

1. Autoriteti ndërmerr arkivimin administrativ të ankesave që janë:
 - a) të papranueshme për shkak të mospërbushjes së kërkesave të përmendura në këtë rregullore ose për shkak të mungesës së informacionit ;
 - b) të paverifikueshme për shkak të ndërprerjes së shkeljes së raportuar;
 - c) të papranueshme sipas nenit 16, pika 1/a-h;
 - d) të papranueshme pasi janë jashtë fushës së zbatimit të kësaj rregulloreje;
 - e) të pabazuara pasi u mungojnë qartë kushtet faktike dhe ligjore të përshtatshme për argumentimin e shkeljes;
2. Autoriteti informon në rrugë elektronike ankuesin për rezultatet e administrimit.
3. Autoriteti informon periodikisht në AMA-s, publikun si dhe çdo palë të interesuar, duke respektuar vërtetësinë e informacionit përputhur me përcaktimet e Ligjit 97/213, i ndryshuar dhe ruajtjen e të dhënave personale

Neni 18

Raportimi

1. Nëse plotësohen kushtet e përmendura, Autoriteti i kërkon platformës së shpërndarjes së videove marrjen e masave të përshtatshme për të parandaluar aksesin e publikut në përmbajtjet të dëmshme sipas përkufizimeve të dhëna në këtë rregullore.
2. Autoriteti i kërkon gjithashtu platformës së shpërndarjes së videove marrjen e masave të përshtatshme, për të parandaluar aksesin e publikut në komunikimet me natyrë tregtare, të cilat cenojnë të drejtat e transmetimit .
3. Raportimi përmban informacion të qartë konstatues dhe ligjor që i lejon platformës së shpërndarjes së videove, të identifikojë shkeljet.

4. Procedura e administrimit të sinjalizimit/ankesës nga ana e Autoritetit përfundon me raportimin e tij pranë platformës së shpërndarjes së videove.

Neni 19 **Kundërvajtjet administrative**

Faqe | 10

1..Të gjithë ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruar të respektojnë nenet 30/1, 32 dhe 32/1 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Shkelja e detyrimeve, të parashikuara për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove sipas neneve 30/1, 32 dhe 32/1 të ligjit si më sipër përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet me sanksion me gjobë në masën 200 000 deri në 2 000 000 lekë.

KREU IV **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 20 **Publikimi**

Kjo rregullore dhe çdo ndryshim i saj publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit në internet.

Neni 22 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi datën e miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive